# DËSHMI ARKIVI

**A-464550**

VERSIONI 1

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Mbrojtja nga shpenzimet në roaming, kontratat duhet të përcaktojnë një vlerë limit prej 6000 lekësh |
| ADRESA | `https://www.cna.al/ekonomi/mbrojtja-nga-shpenzimet-ne-roaming-kontratat-duhet-te-percaktojne-nje-vl-i475048` |
| BURIMI | cna.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 24 shtator 2026, 05:44:12 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 24 shtator 2026, 05:31:00 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `8a9711f8cc5437aedc71cbfab26bdce3cd9a653eee176e6cf9b86d2d70f5f239` |
| TEKSTI | `8fecd10e50984f728ad4b2501151bedcfcd116478c0f82b503aefaa40f8f2cf8` |
| PAMJA | `42544f3eaa6f8d738569df2d84f0567c086963f73525e6dabdfb9ab9749c333c` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `6a92ef7281e7b9072c7e6a2c47ee481835f9793c0d7e86a136b55fbdfbfaff0b` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `230958d0b4668d1bf0212a5d3815d620a5aafa95ae840eb14faf682fa1344cc0` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/6a92ef7281e7b9072c7e6a2c47ee481835f9793c0d7e86a136b55fbdfbfaff0b`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

### E fundit!

x

07:42 Aktualitet

Sot pritet të zhvillohet seanca e radhës parlamentare. Sea...

# Mbrojtja nga shpenzimet në roaming, kontratat duhet të përcaktojnë një vlerë limit prej 6000 lekësh

24 Shtator 2026, 07:31, Ekonomi CNA



Operatorët celularë duhet të vendosin limit financiar për shpenzimet roaming në kontratat e pajtimit mujor, si masë për mbrojtjen e konsumatorëve.

Projekt-rregullorja për "Mbrojtjen e konsumatorëve dhe pajtimtarëve të shërbimeve të komunikimeve elektronike publike" e përgatitur nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), përcakton se informacioni për tarifat roaming duhet të përfshijë dhe sqarime për pajtimtarin për masat për kontrollin e shpenzimeve nëpërmjet limitit financiar ose sasior si dhe për mekanizimin e ndërprerjes në rast të arritjes së limitit së paracaktuar apo zgjedhur nga pajtimtari.

Në termat e përgjithshme të kontratës tip, duhet të përfshihet një limit financiar automatik për roaming prej 5000 lekë, pa TVSH apo 6000 Lekë, me TVSH. Megjithatë, pajtimtari do të ketë të drejtë të zgjedhë një limit tjetër financiar, nëse e kërkon atë në një vlerë të ndryshme nga ajo e parashikuar në kontratën tip.

të ketë të drejtë të zgjedhë një limit tjetër financiar, nëse e kërkon atë në një vlerë të ndryshme nga ajo e parashikuar në kontratën tip.

Projekt-rregullorja e re sanksionon edhe njëherë detyrimet që përdoruesve të shërbimeve celulare t'u dërgohet SMS-ve informuese kur arrihet niveli 80% i konsumit të njësive të të dhënave (data) të përfshira në paketën mujore si dhe kur arrihet niveli 100% i konsumit të njësive të përfshira në paketë dhe pajtimtari është objekt i tarifimit me çmime standarde për njësi konsumi.

Por, në rregulloren e re shtohet një dispozitë që përcakton se, në çdo rast, kur pajtimtari arrin nivelin 100% të konsumit të shërbimeve të përfshira në paketë, para se të fillojë të jetë objekt i tarifimit me çmime standarde për njësi konsumi të shërbimeve, operatori duhet t'i dërgojë pajtimtarit një SMS informuese që përmban çmimet për njësi të shërbimeve kryesore (si thirrje telefonike kombëtare, SMS kombëtare dhe akses në internet) të shprehur në lekë (me TVSH) për njësi të shërbimit (minutë, SMS dhe MB).

Ky njoftim duhet të shoqërohet dhe me një link në faqen e internetit të operatorit ku është e publikuar lista e plotë e çmimeve për njësi konsumi të shërbimeve.

Për shërbimin e aksesit në internet, të përdorur brenda vendit ose në roaming, operatori ka detyrim gjithashtu që, kur arrin limiti 100% i përdorimit të paketës, të kërkojë konfirmimin e pajtimtarit për vijimin e përdorimit të këtij shërbimi me tarifa standarde për njësi (Lek/MB) dhe të vijojë ofrimin e shërbimit vetëm pas marrjes së pëlqimit të shprehur të pajtimtarit.

Projekt-rregullorja e re parashikon që, në termat e përgjithshme të kontratës, të përfshihet informacion për mënyrën e pagesës së shërbimeve dhe kufizimet apo penalitetet e aplikuara në rast të vonesës së pagesës së shërbimeve, si dhe dërgimin e njoftimeve paralajmëruese të operatorit për pajtimtarin në afate të arsyeshme dhe me mjet të qëndrueshme përpara aplikimit të kufizimeve ose penaliteteve.

Sipas projekt-rregullores, masat specifike te ofruesit të shërbimeve për mospagesën e faturave duhet të jenë proporcionale, jodiskriminuese dhe të publikuara dhe në faqen e internetit të operatorit.

Këto masa duhet të përcaktojnë qartë dhe me detaje në kushtet e kontratës rastet kur bëhet kufizimi, ndërprerja e shërbimit apo ndërprerja e kontratës dhe duhet të garantojnë që përdoruesi fundor të njoftohet në kohën dhe mënyrën e duhur përpara aplikimit të tyre./ Monitor






## Të sugjeruara

### Kursi i këmbimit, 24 shtator 2026

**BSH: Rreziqe në tregun e brendshëm nga 3 faktorë, ja sektori më i ekspozuar**

**Rritja e çmimeve të banesave u frenua në gjysmën e parë të 2026**

**Kursimtare apo me më pak para?/ Familjet me kryefamiljare gra shpenzojnë 20 mijë lekë më pak**

**Blerjet e valutës dhe kredia, rritja e ofertës së parasë shënoi rekord të ri në korrik**

**Kostoja e shëndetit, 8% e shqiptarëve nuk përballojnë ekzaminimet, e dyta më e lartë në Europë**

**Monedhat e huaja thellojnë rënien/ Ja sa këmbehen sot euro, paundi dhe dollari**

**Pensionet private me më shumë mbrojtje për anëtarët, rregulla të reja për fondet**

**S&P konfirmon vlerësimin e Shqipërisë në perspektivë të qëndrueshme ekonomike**

**Skemë e re për ndërtimet/ 30% për strehim social, 40% strehim të përballueshëm për shtresën e mesme**

**Euro vijon "rrokullisjen", prek rekord të ri në vlerën e 91.4 lekëve**

**Taksat e karburantit në Europë/ Cili vend takson më shumë benzinën?**

**Hetimet dhe sekuestrimet e SPAK-ut ulin kërkesën për apartamente, kush po blinte?!**

**Punësimi sezonal jashtë solli një rekord të ri historik prej gati 400 milionë eurosh në janar-qershor**

**Monedhat e huaja thellojnë rënien/ Kursi i këmbimit, 22 shtator 2026**

**Të ardhurat buxhetore rriten me 11.7% në 8-mujor, një e treta e shtesës nga ndërtimet e reja**

**Bizneset shqiptare përshpejtojnë digjitalizimin, rritet përdorimi i AI dhe shitjeve online**

**Si e arriti dhe e kaloi Shqipëria mesataren e BE-së me çmimet e ushqimeve**

**Kursi i këmbimit, 21 shtator 2026**

**Moody's paralajmëron Shqipërinë për goditjen që mund të vijë nga tregu i pasurive të paluajtshme**

## editorial

16:30 Editorial

**Agasi, Veliaj, Proda, Hyseni; Harta e një shteti që po shpërbëhet**

**CNA LIVESTREAM**

Na ndiqni edhe në

## acromax

19:53 Acromax / Aldor Nini

**Skandali- dokumenti/ Acromax i Aldor Ninit raportoi CNA duke abuzuar me RTSH**

## opinion

20:06 Opinione Grigels Muçollari

**Po tani, kush do ta shpëtojë Shqipërinë nga turpërimi?!**

19:14 Opinione Luan Rama

**TRADHËTIA NDAJ SHTETIT**

22:05 Opinione Luan Rama

**Kur kryeministri është edhe president dhe presidenti ndihmës i kryeministrit**

## Lifestyle

14:00 Lifestyle

**Ishte shtruar në klinikë rehabilitimi/ Ndërron jetë djali i modeles së njohur**

Presley Gerber, djali i supermodeles Cindy Crawford, ka nd...

09:00 Lifestyle

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.